



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.104

4 tetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Urdhër i MPPTT nr.84, datë 8.9.2006	Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike”.....	4107
Vendim i ERE-s nr.51, datë 15.9.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	4142
Vendim i ERE-s nr.52, datë 15.9.2006	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë “AMAL” sh.p.k. për vitin 2005 dhe vitin 2006.....	4142
Vendim i ERE-s nr.53, datë 15.9.2006	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për vitin 2006.....	4143
Vendim i ERE-s nr.55, datë 20.9.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “WTS Energji” sh.p.k. për periudhën 1 tetor 2005 deri më 31 dhjetor 2005 dhe për vitin 2006.....	4143
Vendim i ERE-s nr.56, datë 20.9.2006	Për afatin e paraqitjes së aplikimeve për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vogla.....	4144
Udhëzim i KQZ nr.2, datë 20.9.2006	Për organizimin dhe funksionimin e zyrave rajonale zgjedhore.	4144

URDHËR
Nr.84, datë 8.9.2006

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË
LICENCAVE PROFESIONALE PËR PUNËT PUBLIKE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.412, datë 15.9.1992 “Për krijimin e komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.613, datë 13.12.1993 “Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike”, sipas materialit bashkëlidhur.
 2. Urdhri nr.36, datë 30.11.2001 “Për miratimin e rregullore “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët dhe shërbimet publike””, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT**
Lulzim Basha

**RREGULLORE PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE
PROFESIONALE PËR PUNËT PUBLIKE**

Mbështetur në nenin 119 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë,
në bazë e zbatim të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.412, datë 15.9.1992 “Për krijimin e Komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.613, datë 13.12.1993 “Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim e projektim të shoqërive”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 15.7.1987 “Për përgatitjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e dokumenteve që i nënshtrohen kontrollit të rreptë”;

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nxjerr këtë rregullore:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

Kjo rregullore përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:

1. organizimin dhe funksionimin e strukturave që merren me procedurat e licencimit të subjekteve;
2. klasifikimin e punimeve të projektimit dhe të zbatimit në ndërtim, prodhimin e materialeve të ndërtimit, kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për t’u pajisur me licencë profesionale;
3. të drejtat që kanë personat fizikë dhe juridikë për t’u pajisur me licencë në fushën e ndërtimit, ndryshimet që u bëhen atyre dhe detyrimin e administratës shtetërore për realizimin e trajtimit konform dispozitave ligjore të kërkesave të personave fizikë dhe juridikë.

Neni 2

Përkufizimi i termave

“Komision” – Komision i posaçëm që krijohet pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për dhënien e licencave profesionale në fushën e ndërtimit, material-ndërtimit, mbikëqyrjes e kolaudimit të tyre, laboratorëve të kontrollit të materialeve dhe punimeve.

“Licencë profesionale” - Dokument me të cilin pajiset çdo person fizik ose juridik vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrojë privatisht profesionin e projektuesit a zbatuesit në fushën e punëve publike.

“Vjetërsi pune” - Vite pune gjithsej, dokumentuar me librezë pune ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të.

“Vjetërsi pune në projektim” - Vite pune të dokumentuara në institucione shtetërore, publike ose studio private projektimi.

“Vjetërsi pune në zbatim” - Vite pune të dokumentuara në ndërmarrje shtetërore, publike ose shoqëri private që zbatojnë punë publike.

“Arsimi i lartë përkatës” - Arsimi në degën përkatëse dhe specialiteti në diplomë.

“SSH” - Standarte shtetërore.

“KTP” - Kushte teknike të projektimit.

“KTZ” - Kushte teknike të zbatimit të punimeve.

“Punë publike” - Konsiderohet veprimtaria për realizimin e një vepre publike.

“Klasë – Kategori - Klasifikimi i punëve në projektim, zbatim sipas llojeve të tyre dhe nënlojeve.

“Ekspert” - Specialist i licencuar i fushës përkatëse.

“Kartelë shoqëruese e kërkesës” - Fleta evidentuese që shoqëron çdo kërkesë me shënimet përkatëse të punonjësve të sektorit të licencimit në ndërtim nga pranimi deri tek vendimi i Komisionit.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNSKIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

KOMISIONI I POSAÇËM PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

Neni 3

Krijimi – përbërja

1. Komisioni i posaçëm i dhënies së licencave profesionale ngrihet me urdhër të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në të cilin përcaktohet përbërja, kryetari, nënkryetari, sekretari dhe anëtarët:

- Si rregull sekretar i Komisionit është përgjegjësi i sektorit të licencimit në ndërtim.

- Anëtarë të Komisionit janë specialistë me arsim të lartë të projektimit ose zbatimit në ndërtim, material-ndërtim me vjetërsi pune jo më pak se 15 vjet.

2. Përbërja dhe pjesëtarët e Komisionit mund të ndryshohen me propozim të Kryetarit dhe urdhër të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Komisioni ushtron veprimtari në përputhje me këtë rregullore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kritere në këtë fushë.

4. Komisioni merr vendime për dhënie licence profesionale personale dhe për shoqëri, shtesa dhe rinovime të licencave profesionale, ndryshime të drejtuesve të shoqërisë, kryesisht në kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4

Mbledhjet e Komisionit

1. Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari i tij.

- Si rregull ai mblidhet çdo muaj, ndërmjet datave 25 – 30.

- Me kërkesë të kryetarit të Komisionit mblidhet dhe jashtë radhe.

2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se tre të katërtat e Komisionit.

- Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari i Komisionit.

3. Në mbledhje të radhës Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet e

paraqitura para datës 10 të muajit vijues.

4. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll.

Neni 5

Përgatitja e materialeve për Komision

1. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës të Komisionit hartohet nga Drejtoria e Licencimit dhe miratohet nga kryetari i Komisionit.

2. Komisioni shqyrton materiale që kanë të bëjnë me licencimin e subjekteve, ankesa të tyre, informacione e kërkesa të organeve të administratës publike ose komunitetit, përfundime nga kontrollet e kryera.

3. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen pjesëtarëve të Komisionit nga sekretari i tij jo më vonë se pesë ditë para ditës së caktuar për mbledhje.

- Materialet që kanë të bëjnë me licencimin e subjekteve përgatiten nga sektori i licencimit në ndërtim dhe nënshkruhen nga përgjegjësi i sektorit dhe përpunuesit e tij.

- Materialet e tjera përgatiten nga Drejtoria e Licencimit dhe nënshkruhen nga drejtori i saj.

Neni 6

Ekspertët

1. Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, caktohen ekspertë. Çdo grup ekspertësh drejtohet nga një anëtar Komisioni.

2. Ekspertët përzgjidhen nga Drejtori i Drejtorisë së Licencimit dhe miratohen me urdhër të kryetarit të Komisionit brenda datës 15 të muajit.

3. Ekspertiza e përgatitur me shkrim dorëzohet në Drejtorinë e Licencimit jo më vonë se data 25 e muajit vijues. Ekspertët për punën e kryer shpërblehen me urdhër të kryetarit të Komisionit.

Neni 7

Marrja e vendimeve

Komisioni merr vendim jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i dokumenteve për licencim në sektorin përkatës dhe brenda afateve të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” për kërkesa e ankesa të tjera.

Neni 8

1. Vendimet në Komision si rregull merrren me konsensus; kur ky nuk arrihet me shumicën e votave të pjesëmarrësve.

- Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

2. Vendimet e Komisionit zbardhen nën përgjegjësinë e sekretarit të tij, nënshkruhen nga kryetari dhe pjesëtarët e Komisionit që kanë qënë pjesëmarrës në mbledhje.

- Vendimet e Komisionit përgatiten në tri kopje: njëra dorëzohet në zyrën e arkiv-dokumentacionit, tjetra në sektorin e licencimit në ndërtim për veprime të mëtejshme dhe e treta në praktikën e Komisionit.

Neni 9

Puna e kryer nga anëtarët e Komisionit dhe e punonjësve të tjerë që lidhen me këtë proces shpërblehet.

Antarët e Komisionit, pjesëmarrës në mbledhje shpërblehen me 5000 lekë me urdhër të kryetarit. Listëprezenca hartohet nga sekretari i Komisionit dhe nënshkruhet nga kryetari i tij.

SEKTORI I LICENCIMIT NË NDËRTIM

Neni 10

Sektori i licencimit në ndërtim është organizuar dhe funksionon pranë Drejtorisë së Licencimit.

- Organizimi i sektorit bëhet në bazë e zbatim të strukturës organizative të Ministrisë.

- Veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe këtë rregullore.

Neni 11

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj sipas kësaj rregulloreje, dërgohen me postë rekomandë.

- Dokumentet për licencë duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

- Në faqen e jashtme të zarfit që mban adresën e plotë të subjektit kërkues, nënshkrimin dhe vulën e tij, shkruhet adresa e Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe shënimi “Dokumente për licencë profesionale”.

2. Zarfat e mbyllur tërhiqen çdo ditë nga përgjegjësi i sektorit të licencimit në ndërtim, regjistrohen në protokollin e posaçëm të sektorit dhe shoqërohen me kartelë.

3. Në kartelën shoqëruese evidentojnë shënime dhe nënshkruajnë punonjësit që pranojnë dhe japin mendim për kërkesën deri te vendimi i Komisionit.

- Mendimi i sektorit në materialin që i paraqitet Komisionit bazohet në këtë kartelë.

4. Çdo kërkesë shqyrtohet paraprakisht brenda ditës, nëse përmban të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës sipas kësaj rregulloreje.

- Kërkesat që pas shqyrtimit rezultojnë të parregullta, nënshkruhen pas motivimit, nga pranuesi dhe përcillen te përgjegjësi i sektorit për përgjigje të interesuarit.

5. Kërkesa bëhet jo më vonë se 30 ditë para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së licencës.

Neni 12

Shqyrtimi i kërkesave

Çdo kërkesë e pranuar:

- i nënshtrohet opionencës së specialistit nëse ajo është në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore;

- shoqërohet detyrimisht me mendimin e motivuar e të nënshkruar të specialistit dhe përgjegjësit të sektorit në kartelën shoqëruese të kërkesës.

Neni 13

Ruajtja dhe arkivimi

1. Sektori i licencimit në ndërtim, mbi bazën e vendimit të Komisionit, përgatit licencat në dy kopje origjinale, njëra, prej të cilave, pas nënshkrimit nga kryetari, i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra ruhet për arkivim.

2. Licencat profesionale janë dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë.

- Format i tyre propozohet nga Komisioni dhe miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Sektori i licencimit në ndërtim përgjigjet për arkivimin sipas rregullave në fuqi të licencës, dokumentacionit, kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për pagesën sipas tarifës përkatëse.

4. Tarifat për personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që licencohen janë sipas lidhjes nr.1 të kësaj rregullore.

Neni 14

Komunikimi me subjektet

1. Përgjegjësi i sektorit të licencimit në ndërtim komunikon çdo ditë, sipas rregullit të brendshëm të Ministrisë, me subjektet e interesuara, argumenton refuzimin pjesor ose të plotë të kërkesës dhe jep sqarimet e nevojshme në zbatim të kësaj rregulloreje.

2. Shpërndarja e licencave të interesuarve bëhet dorazi nga sektori i licencimit në ndërtim ndërmjet

datave 10 – 30 të muajit pasardhës, por jo më vonë se 60 ditë nga marrja e vendimit.

3. Drejtoria e Licencimit kërkon ndaj subjekteve të licencuara respektimin e detyrimeve që burojnë nga kjo rregullore.

Neni 15

Bashkëpunimi me administratën publike

Drejtoria e Licencimit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, mban lidhje të qëndrueshme me insitucionet në vartësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, administratën publike dhe organet e qeverisjes vendore. Ai:

- kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij;
- trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave të tyre.

Neni 16

Veprime drejtpërdrejt nga sektori

1. Sektori i licencimit në ndërtim ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në Komision, për rastet e shënuara më poshtë, mbështetur në dokumentacionin përkatës të paraqitur në zbatim të kësaj rregulloreje:

- Ndryshim dhe shtesë në drejtuesit ligjor të shoqërisë;
- Ndryshim emërtim shoqërie;
- Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrim i tyre;
- Ndryshimi i drejtuesit teknik ose shtesë drejtuesi teknik, në rastet kur licenca e tyre apo ekzistuese e shoqërisë nuk ka nevojë për konvertim apo shtesa në kategoritë sipas rregullores në fuqi;
- Zgjatjen e afatit të licencave personale apo të shoqërive, në rastet kur licenca e tyre apo ekzistuese e shoqërisë nuk ka nevojë për konvertim të kategorive sipas rregullores në fuqi.

2. Për çdo rast të tillë paraqitet kërkesë me shkrim dhe veprohet sipas nenit 11 të rregullores.

3. Vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur sipas pikës 1 bëhet në grup me punonjës të sektorit. Për çdo rast vlerësimi mbahet procesverbal.

- Grupi i vlerësimit ngrihet nga Drejtori i Drejtorisë së Licencimit dhe përbëhet nga tre antarë.

Neni 17

Paraqitja, protokoli, regjistrat, arkivi

1. Çdo kërkesë dhe dokumentacioni shoqërues sipas kësaj rregulloreje duhet të jetë i daktilografiuar dhe në gjuhën shqipe (dokumentet e përkthyer noterizohen).

2. Çdo dokument i fotokopjuar duhet të jetë i noterizuar.

3. Sektori i licencimit në ndërtim mban dhe ruan sipas rregullave në fuqi:

- protokoll për evidentimin e kërkesave të subjekteve për licencim;
- regjistër themeltar për licencat profesionale personale dhe të shoqërive;
- regjistër themeltar për regjistrimin e shoqërive;

4. Arkivi i sektorit të licencimit në ndërtim, sipas mundësive, organizohet bashkë ose veças nga arkivi i Ministrisë, me urdhër të veçantë të titullarit.

KREU III

LICENCAT PROFESIONALE – KLASIFIKIMI DHE KATEGORITË KUSHTE DHE KRITERE NË PROCEDURAT E LICENCIMIT

Neni 18

Licenca, klasifikimi e kategoritë e punimeve

1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë

veprimtari të caktuar sipas klasifikimit dhe kategorive të punimeve të fituara në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim e laboratorë të kontrollit të materialeve e punimeve duke u mbështetur kryesisht në profilin e diplomës së arsimit të lartë, eksperiencën në punë, kushtet e kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Klasifikimi dhe kategoritë e punimeve të projektimit dhe të zbatimit, sipas të cilave kërkohet licencë profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet nr.2, nr.3 dhe nr.4 të rregullores.

3. Licencat profesionale personale, apo për shoqëri sipas shkallës së aftësisë, afatit kohor, ndryshimeve dhe saktësimeve të mundshme rinovohen në kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 19

Llojet e licencave dhe elementet e saj

1. Llojet e licencave janë:

- Licencë profesionale personale;
- Licencë profesionale për shoqëri.

2. Licencat profesionale personale, apo për shoqëri, jepen për këto punë publike:

- Punë projektimi;
- Punë zbatim;
- Punë laborator;
- Mbikëqyrje punimesh;
- Kolaudim punimesh.

3. Licenca përmban këto elemente:

- Klasa dhe kategoria;
- Afati i vlefshmërisë;
- Numri i regjistrimit themeltar;
- Shenja dalluese;
- Fotografia e drejtuesit teknik.

Neni 20

1. Licenca nuk lejohet të transferohet nga një person fizik a juridik te tjetri.

2. Kur një subjekt humbet licencën profesionale njofton menjëherë zyrtarisht komisionin e posaçëm (Sektori i licencimit në ndërtim) dhe pajiset me dublikatë me plotësimin e dokumenteve sipas nenit 31.

3. Licencat personale tërhiqen nga vetë personi i licencuar ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).

4. Licencat e shoqërive tërhiqen domosdoshmërisht edhe në prani të drejtuesit apo drejtuesve teknikë.

5. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknik, drejtuesve ligjorë apo ndryshim të emrit apo selisë, përpara se të tërheqin licencën duhet të dorëzojnë origjinalin e licencës parardhëse.

6. Personat të cilët janë të pajisur me licensë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, të cilët punësohen pranë shoqërive për punë publike, duhet të dorëzojnë kopjen origjinale të kësaj licence pranë arkivës së sektorit të licencimit në ndërtim. Kjo licencë i kthehet përsëri personit në momentin që ai shkëputet nga pozicioni i drejtuesit teknik në shoqëri për punë publike.

Neni 21

Kufizime në dhënien e licencave

1. Nuk lejohet të pajisen me licencë (drejtues teknik e ligjor) për shoqëri, personat që punojnë në institucionet qendrore apo buxhetore dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve bie ndesh me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nënpunësit civil”, ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

2. Shoqëritë për zbatim punesh publike, drejtuesit teknikë të tyre dhe specialistët e licencuar që punojnë pranë tyre nuk mund të licencohen si persona fizikë e juridikë për mbikëqyrje e kolaudim për punë publike.

Neni 22

Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave nga data e lëshimit të tyre janë:
 - 5 vjet për licencë profesionale të shoqërive për projektim, zbatim, e laboratorë të kontrollit;
 - 10 vjet për licencë profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim, në punë publike;
 - Përgjithmonë për licencë profesionale personale për projektim, mbikëqyrje, kolaudim e laboratorë të kontrollit.
2. Afati kohor minimal për të kërkuar shtesë kategori në licencë profesionale personale dhe të shoqërive është një deri dy vjet në vartësi të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur, punëve të kryera.

KREU IV

KUSHTET PARAPRAKE PËR TË FITUAR LICENCË DETYRAT DHE TË DREJTAT E SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN

Neni 23

1. Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e punëve publike, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre, materialeve të ndërtimit dhe laboratorëve të provave të materialeve dhe punimeve, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë sektorit të licencimit në ndërtim për t'u pajisur me licencë profesionale personale ose për shoqëri, pasi të ketë plotësuar kushtet paraprake që shënohen më poshtë.
2. Kushtet dhe kriteret të cilat kërkohen për të fituar klasa e kategori të punimeve të projektimit dhe zbatimit të punëve publike jepen në lidhjet nr.5 dhe nr.6 të rregullores.

A. KUSHTET PARAPRAKE PËR LICENCË PROFESIONALE PERSONALE NË PUNËT PUBLIKE

Neni 24

- a) Për projektim:
 - Të jetë diplomuar në arsimin e lartë përkatës;
 - Të ketë vjetërsi pune në projektim mbi 3 vjet në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik.
- b) Për zbatim punime:
 - Të jetë diplomuar në arsimin e lartë përkatës dhe të ketë mbi 2 vjet vjetërsi pune në zbatim punimesh të ngjashme me ato që kërkon të licencohet;
 - Të ketë diplomën për përfundimin e arsimit të mesëm përkatës dhe mbi 10 vjet vjetërsi pune në zbatim punimesh të ngjashme me ato që kërkon të licencohet.
- c) Për prodhim materiale ndërtimi:
 - Të jetë diplomuar në arsimin e lartë përkatës dhe të ketë mbi 2 vjet vjetërsi pune në zbatim punime ose prodhim materiale ndërtimi;
 - Të ketë diplomën për përfundimin e arsimit të mesëm përkatës dhe mbi 10 vjet vjetërsi pune në prodhim materiale ndërtimi.

Për pikën a, b, c në rastet kur studentët janë diplomuar me mesatare notash 9.5 ose mbi këtë mesatare, atëherë personi aplikon për licencë menjëherë pas përfundimit të diplomës pa pritur afatin.

d) Për laboratorët e provave:

- Të ketë diplomën për arsimin e lartë përkatës;
- Të ketë vjetërsi pune mbi 2 vjet në laboratorë të licencuar ose shkencorë.

e) Për mbikëqyrës zbatim punime:

- Të jetë diplomuar në arsimin e lartë përkatës;
- Të ketë mbi 15 vjet vjetërsi pune në zbatim në profesionin përkatës;
- Të ketë fituar licencë profesionale personale për zbatim punimesh;
- Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar në shoqëri për zbatim, punë publike.

f) Për kolaudator zbatim punime:

- Të jetë diplomuar në arsimin e lartë përkatës;
- Të ketë mbi 15 vjet vjetërsi pune në projektim, zbatim ose Universitetin Politeknik;

- Të ketë fituar licencë profesionale në projektim ose zbatim pune publike;
- Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar në shoqëri për zbatim, punë publike.

B. LICENCA PROFESIONALE E SHOQËRISË DHE DREJTUESI TEKNIK I SAJ

Neni 25

1. Drejtuesi teknik i Shoqërisë është një ose më shumë persona fizikë, pajisur me licencë profesionale personale dhe vjetërsi në punë jo më pak se 5 vjet.
2. Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur në licencën profesionale personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.
3. Për të vlerësuar/demostruar aftësinë e mjaftueshme njerëzore, materiale e financiare të shoqërisë plotësohet dokumentacioni sipas lidhjes 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje.
4. Në asnjë rast nuk lejohet që drejtuesi teknik i shoqërisë të jetë me arsim të mesëm ose arsim të lartë të pambaruar (i padiplomuar).
5. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi në dy a më shumë shoqëri.
6. Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë më shumë se një vit.
7. Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe kontratë punësimi.

C. KUSHTET PARAPRAKE PËR LICENCË PROFESIONALE PËR SHOQËRI VENDASE NË PUNËT PUBLIKE

Neni 26

Drejtuesi/drejtuesit teknikë dhe shoqëria që ushtron veprimtari në projektim, zbatim punime, prodhim materiale ndërtimi, laboratorë për prova, mbikëqyrje dhe kolaudim të punëve publike duhet të plotësojë kushtet paraprake të mëposhtme që të fitojë licencë profesionale.

- a) Për projektim:
 - Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale për projektim.
 - Të ketë aftësi projektuese, burime njerëzore, materiale e financiare të mjaftueshme.
- b) Për zbatim punime:
 - Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë me arsim të lartë të pajisur me licencë profesionale personale për zbatim punimesh.
 - Të ketë aftësi ndërtuese, burime njerëzore, materiale e financiare të mjaftueshme.
- c) Për prodhim materiale ndërtimi:
 - Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë me arsim të lartë të pajisur me licencë profesionale personale për prodhim materiale ndërtimi.
 - Të ketë aftësi prodhuese, burime njerëzore, materiale e financiare të mjaftueshme.
- d) Për mbikëqyrës punime zbatimi:
 - Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale për mbikëqyrës punimesh;
 - Shoqëria të mos jetë licencuar në fushën e zbatimit të punëve publike.
- e) Për kolaudator punime zbatimi:
 - Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale për kolaudator punimesh.
 - Shoqëria të mos jetë licencuar në fushën e zbatimit të punëve publike.

D. KUSHTET PARAPRAKE PËR LICENCË PROFESIONALE PËR SHOQËRI TË HUAJ OSE TË PËRBASHKËT

Neni 27

1. Në rastet kur drejtuesi teknik i shoqërisë së përbashkët ose të huaj është vendas zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për shoqëritë vendase.
2. Kur shoqëria e huaj ose e përbashkët ka drejtues teknik të huaj bëhet ekuivalentimi i licencës së

tij (ose shoqërisë) me klasat dhe kategoritë e punimeve publike sipas kësaj rregulloreje dhe zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për shoqëritë vendase.

3. Ekuivalentimi i licencës së drejtuesit teknik (ose shoqërisë) së huaj bëhet mbështetur në vlerësimin e ekspertëve sipas nenit 6 të rregullores.

E. TË DREJTAT DHE DETYRAT E SUBJEKTEVE TË LICENCUAR

Neni 28

1. Të njohë dhe të kryejë veprimtari në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për projektim, punë publike dhe këtë rregullore.

2. Të njohë dhe zbatojë standardet, kushtet teknike të projektimit e zbatimit, si dhe euronormat e pranuar nga vendi ynë.

3. Të njohë dhe zbatojë rregulloren e sigurimit teknik në punë.

4. Çdo shoqëri e licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të Drejtuesit/Drejtesve teknikë.

- Drejtuesi teknik i shoqërisë detyrohet të njoftojë një muaj më parë zyrtarisht me kërkesë të motivuar Drejtuesin ligjor për largimin nga shoqëria.

- Çdo largim pa arsye shoqërohet me heqjen jo më pak se një vit të licencës.

5. Të paraqesë te drejtuesi ligjor kërkesë të noterizuar zyrtare për prishjen e kontratës.

6. Të japë informacion sipas pasqyrave P1 – P2 – P3, bashkëlidhur kësaj rregulloreje në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (sektori licencimit në ndërtim).

7. Të kontribuojë me të gjithë aftësinë ndërtuese në dispozicion në rastet e emergjencave civile.

KREU V

DOKUMENTET QË SHOQËROJNË KËRKESËN PËR LICENCË PROFESIONALE

Neni 29

Për pajisje me licencë profesionale individuale

A. “Për pajisje me licencë individuale për herë të parë”

Kërkesa e aplikuesit për pajisje me licencë individuale, ku përcaktohen kategoritë sipas zërave të punimeve me të cilat personi kërkon të licencohet dhe veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV, shoqërohet me:

- Kopje të noterizuar të diplomës;

- Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë rezulton 9.5 ose më shumë, paraqitet kopje e noterizuar e listës së notave.

- Certifikatë personale me fotografi (e lëshuar jo më përpara se 3 muaj nga aplikimi për licencë).

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektsh ku personi ka qenë bashkautor, certifikata kursi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim noterial i personit në lidhje me gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës (sipas formatit të lidhjes nr.8/1).

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punime zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin noterial të mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri). (sipas formatit të lidhjes nr.8/2).

B. “Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale”

Kërkesa e aplikuesit për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale, ku përcaktohen kategoritë sipas zërave të punimeve të cilat personi kërkon të shtojë në licencë dhe veprimtaria e tij e kryer nga marrja e licencës parardhëse në formën e CV, shoqërohet me:

- Certifikatë personale me fotografi (e lëshuar jo më përpara se 3 muaj nga aplikimi për licencë).

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektsh ku personi ka qenë bashkautor, certifikata kursi apo specializimi që ka lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim noterial i personit për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës. (sipas formatit të lidhjes nr.8/1)

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punime zbatimi

personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin noterial të mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri) (sipas formatit të lidhjes nr.8/2).

Neni 30

Për pajisje me licencë profesionale për shoqëri

A. “Për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë”

Kërkesa e drejtuesit ligjor për pajisje me licencë shoqërie, ku përcaktohen emri shoqërisë, drejtuesit ligjorë dhe teknikë të saj, përmban dhe deklarimin se angazhohet të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP, KTZ, STASH dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit, si dhe të dërgojë informacion periodik për veprimtarinë e shoqërisë. Gjithashtu shoqërohet me:

- Kopje të noterizuar të vendimit të regjistrimit në gjykatë për të kryer aktivitetin për të cilin kërkon të licencohet.

- Kopje të noterizuar të licencës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë të shoqërisë.

- Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve ligjorë për gjendjen në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës. (sipas formatit të lidhjes nr.8/1).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve teknikë për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me fushën ku kërkon të licencohet dhe për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera ndërtimi dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin (sipas formatit të lidhjes nr.8/3).

- Informacion në lidhje me aftësinë ndërtuese të shoqërisë, ku të përfshihen: mjetet, fuqia punëtore dhe aftësia teknike.

- Shoqëritë e huaja ose me kapital të përbashkët paraqesin dhe kredibilitetin nga ana financiare.

B. “Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë”

Kërkesa e drejtuesit ligjor për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë, ku përcaktohen drejtuesit ligjorë dhe teknikë të saj, dhe kategoritë që kërkon të shtohen në licencën e shoqërisë, shoqërohet me:

- Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve ligjorë për gjendjen në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës. (sipas formatit të lidhjes nr.8/1).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve teknikë për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me fushën ku kërkon të licencohet dhe për gjendjen e tij në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera ndërtimi dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin (sipas formatit të lidhjes nr.8/3).

Drejtuesi teknik plotëson dokumentacionin për shtesa në licencën e tij personale (të cilat kalojnë automatikisht shoqërisë) sipas kërkesave të 2 pikave të para të nenit 29 të riformular.

Për pajisjen me licencë profesionale ose shtesa të saj, krahas kërkesave të mësipërme, shoqëria duhet të plotësojë periodikisht dhe t'i dërgojë në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit pasqyrat bashkëlidhur kësaj Rregulloreje (P1, P2, P3).

Neni 31

Për zgjatjen e afatit të licencave dhe dublikatë

A. “Për zgjatjen e afatit të licencës personale apo dublikatë”

Kërkesa për zgjatjen e afatit të licencës e nënshkruar nga subjekti aplikues, ku përcaktohet numri i licencës që kërkon të rinovojë dhe data e regjistrimit të saj, shoqërohet me:

- Vetëdeklarim noterial i personit për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë, gjykatës në lidhje me fushën ku kërkon të rilicencohet dhe me organet e policisë së ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr.8/4).

- Në rastin kur kërkohet zgjatje afati për licencën e mbikëqyrje e kolaudit, vetëdeklarim noterial i mësipërm i personit shoqërohet dhe me gjendjen e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (sipas formatit të lidhjes nr.8/5).

B. “Për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë”

Kërkesa për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë e nënshkruar nga subjekti aplikues, ku

përcaktohet numri i licencës që kërkon të rinovojë dhe data e regjistrimit të saj, shoqërohet me:

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve ligjorë në lidhje me gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për fushën ku kërkon të rilicencohet dhe në lidhje me organet e policisë së ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr.8/6).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve teknikë për gjendjen në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për fushën ku është licencuar dhe për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera ndërtimi dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin (sipas formatit të lidhjes nr.8/3).

- Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Informacion në lidhje me veprimtarinë e ushtruar gjatë periudhës së përdorimit të licencës, ku të përfshihen objektet e realizuara, realizimi në lekë dhe fuqia punëtore.

Për zgjatjen e afatit të licencës profesionale, krahas kërkesave të mësipërme, shoqëria duhet të plotësojë periodikisht dhe t'i dërgojë në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit pasqyrat bashkëlidhur kësaj rregulloreje (P1, P2, P3).

Neni 32

Për ndryshim ose shtesë të drejtuesit ligjor

Kërkesa për ndryshimin e drejtuesit ligjor apo shtesë të tij, shoqërohet me:

- Kopje të noterizuar të vendimit të gjykatës ku përcaktohet ndryshimi i drejtuesit ligjor.

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve ligjorë në lidhje me gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për fushën ku kërkon të rilicencohet dhe në lidhje me organet e policisë së ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr.8/6)

- Kontratat midis drejtuesit ligjor të ri dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

Neni 33

Për ndryshim të drejtuesit teknik

Kërkesa për ndryshimin e drejtuesit teknik apo shtesë të tij e nënshkruar nga subjekti aplikues ku përcaktohen ndryshimet përkatëse që kërkojnë, shoqërohet me:

- Miratimin noterial të palëve që kryejnë shkëputjen e marrëdhënieve kontraktuale në fuqi ose deklarimin noterial të njëres palë në rast se kontratës së lidhur midis tyre i ka mbaruar afati (kontratës së depozituar në aplikimin e mëparshëm).

- Kopje të licencës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri.

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve ligjorë për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me fushën ku është licencuar (sipas formatit të lidhjes nr.8/1).

- Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të ri, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim noterial i drejtuesve teknikë që shtohen teknikë për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me fushën ku kërkon të rilicencohet dhe për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera ndërtimi dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune me shtetin” (sipas formatit të lidhjes nr.8/3).

Neni 34

Për ndryshim emërtim shoqërie

Kërkesa për ndryshimin e emrit të shoqërisë, shoqërohet me:

- Vendimin e gjykatës në lidhje me ndryshimin e emrit të shoqërisë.

Neni 35

Për ekuivalentimin e licencës së subjekteve të huaj

1. Kërkesë me shkrim

2. Curriculum Vitae.

3. Licencë profesionale e lëshuar në shtetin përkatës.
4. Diploma e fotokopjuar e noterizuar.
5. Dëshmi penaliteti.
6. 2 copë fotografi 3x4.

Neni 36

Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrimi

Në rastin kur subjekti fizik ose juridik nuk ushtron më veprimtari, kur një shoqëri, ndahet, bashkohet ose falimenton, kur pjesë të saj fitojnë cilësi të reja juridike, paraqet pranë sektorit të licencimit në ndërtim kërkesë për evidentimin e ndryshimeve.

Në rastin e mbylljes së veprimtarisë, shoqëria paraqet:

- njoftim me shkrim nga drejtuesi ligjor, për çregjistrimin e shoqërisë nga libri themeltar i regjistrimit.
- vendimi i Gjykatës.
- Detyrimet ndaj shtetit në organet tatimore.

KREU VI

REGJISTRIMI LICENCAVE PROFESIONALE DHE SHOQËRIVE

Neni 37

Regjistrimi licencave profesionale

Licenca hartohet në dy kopje origjinale dhe regjistrohet në regjistrat themeltarë të licencave profesionale personale dhe të shoqërive duke pasqyruar edhe përmbajtjen e saj.

Regjistrimet duhet të jenë të sakta, të qarta, pa korrigjime, me vijueshmëri të numrit rendor dhe pa shkurtime.

Në regjistrat themeltarë të regjistrimit nuk lejohet të fshihet asgjë.

Rregullimet bëhen me numër rendor të ri me fraksion (germa kapitale).

Një kopje origjinale e licencës së bashku me praktikën e sjellë nga kërkuesi, mbahet në arshivë pranë sektorit të licencimit në ndërtim, dhe në fund të vitit dorëzohet në sektorin arkiv dokumentacionit të Ministrisë.

KREU VII

SANKSIONE

Neni 38

Masa disiplinore ndaj subjekteve të licencuara

Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit apo pezullimin e përkohshëm në projektim, zbatim, etj. për periudha të ndryshme, si individë apo shoqëri, bëhet nga Komisioni, në këto raste kur:

1. Konstatohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme apo dokumente të pavërteta;
2. Ka falsifikime të evidencave e formularëve që kërkohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit në zbatim të kësaj rregulloreje;
3. Kryen veprimtari pa drejtues teknik/nuk plotëson detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore;
4. Drejtuesi teknik largohet pa arsye nga shoqëria;
5. Ka propozime të motivuara nga Policia e Ndërtimit, organet e qeverisjes vendore, (bashki, qark), prefekturë, tatim-taksa, dogana etj. për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim.

Për çdo rast hartohet raport vlerësimi dhe shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

Masa për shoqëritë, drejtuesit teknikë dhe personat fizikë të licencuar, sipas shkeljeve të bëra gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë me heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar: 6 muaj, 1 vit, 2 vjet, 3 vjet ose përgjithmonë; tërësisht ose pjesërisht për klasat dhe kategoritë e licencës.

Për masat e marra njoftohet subjekti përkatës dhe Policia e Ndërtimit dhe për rastet e deklarimeve

të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen dhe me kallëzim në organet kompetente.

Neni 39

Ankimi

Për çdo vendim të Komisionit, në zbatim të nenit 38 të kësaj rregulloreje, personat fizikë apo juridikë, kanë të drejtën e ankimit te Ministri Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda 10 ditëve nga data e publikimit.

Titullari i Ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos brenda 10 ditëve:

- Lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni;
- Kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në Komision;
- Anulon vendimin e marrë.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 40

1. Kur personi fizik i licencuar bëhet drejtues teknik i një shoqërie, kategoritë e licencës profesionale të shoqërisë jepen në përputhje me këtë rregullore.

2. Pjesë e kësaj rregulloreje janë lidhjet 1 ÷ 8 bashkëngjitur.

3. Komisioni mbështetur në dokumente e referenca të kërkuarit dhe vlerësim të ekspertëve shqyrton ankesa për rinovim kategorish të fituara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe merr vendimet përkatëse.

4. Edhe në rastet kur me kërkesë të investitorit për mbikëqyrës dhe kolaudator për zbatim punimesh kërkohet të licencohen punonjës të tij, si rregull zbatohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 24.

5. Rregullorja e dhënies së licencave e miratuar me urdhër të Ministrit nr.36, datë 30.11.2001 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët dhe shërbimet publike”, shfuqizohet.

6. Verifikimi i deklarimeve kryhet nga sektori i licencimit në ndërtim pranë institucioneve kompetente, brenda 30 ditëve nga hartimi i materialit përkatës për Komisionin e posaçëm. Procedurat dhe afatet e verifikimit nuk pengojnë procesin e licencimit të subjekteve. Në rastet e konstatimit të deklarime të rreme zbatohen masat e përcaktuara në nenin 38 të kësaj rregulloreje.

7. Përveçse kur parashikohet ndryshe në dispozitat e kësaj rregulloreje, licencat e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren miratuar me urdhërin e Ministrit, nr.36, datë 30.11.2001 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët dhe shërbimet publike”, do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS

Lidhja 1 Tarifat e pagesës për marrjen e licencës profesionale

Lidhja 2 Klasifikimi dhe kategoritë e punimeve të projektimit

Lidhja 3 Klasifikimi dhe kategoritë e punimeve të zbatimit

Lidhja 4 Klasifikimi dhe kategoritë e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit

Lidhja 5 Kushte dhe kriteret për të fituar klasa dhe kategori të projektimit

Lidhja 6 Kushte dhe kriteret për të fituar klasa dhe kategori të zbatimit në punët publike

Lidhja 7 Laboratorët e kontrollit të materialeve të ndërtimit dhe klasifikimi i tyre

Lidhja 8 Vetëdeklarimet

P – 1 Punonjësit – pagat – makineritë

P – 2 Tregues të veprave të ndërtuara

P – 3 Vëllimet e punimeve / prodhimeve

TARIFA

Për personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj, që pajisen me licencë profesionale, zbatohen këto tarifa:

1. Persona fizikë	6000	(gjashtë mijë)	lekë
2. Shtesë në licencë për persona fizikë	3000	(tre mijë)	lekë
3. Zgjatje afati për persona fizikë	3000	(tre mijë)	lekë
4. Konvertim licence	10 000	(dhjetë mijë)	lekë
5. Persona juridikë	60 000	(gjashtëdhjetë mijë)	lekë
6. Shtesë në licencë për persona juridikë	40 000	(dyzet mijë)	lekë
7. Zgjatje afati licence për persona juridikë	25 000	(njëzet e pesë mijë)	lekë
8. Ndryshim dhe shtesë drejtuesi ligjor e teknik	6000	(gjashtë mijë)	lekë
9. Ndryshim i emrit të shoqërisë	6000	(gjashtë mijë)	lekë
10. Laboratorë për prova	60 000	(gjashtëdhjetë mijë)	lekë
11. Shtesë në licencë të laboratorëve	40 000	(dyzetë mijë)	lekë
12. Zgjatje afati licence të laboratorëve	25 000	(njëzet e pesë mijë)	lekë
13. Nxjerrje të dhëna nga Regjistri Themeltar	1000	(një mijë)	lekë
14. Dublikatë personave fizikë	2000	(dy mijë)	lekë
15. Dublikatë personave juridikë	10 000	(dhjetë mijë)	lekë

TABELA E KLASIFIKIMIT TË PUNIMEVE TË PROJEKTIMIT

- Sipas klasave dhe kategorive –

1. PROJEKTUES URBANIST

- a- Masterplane - studime e plane rajonale urbanistike.
- b- 1 – Plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara – 2 – qytete.
- c- Studime pjesore urbanistike.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a- Objekte civile - industriale - turistike deri 5 kate.
- b- Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate.
- c- Objekte sportive.
- d- Projektim interiere.
- e- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- b- 1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.
- c- 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a- Instalime hidrosanitare.
- b- Instalime termoteknik – ventilimi - kondicionimi.
- c- Linja e rrjeta elektrike – telefonike – radiotelefoni – citofoni –sistem alarmi – televiziv etj., për objekte civile, industriale, turistike.
- d- Sisteme komplekse të telekomunikacionit.
- e- Sisteme të furnizimit me gaz.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- a- Diga – galeri – tunele hidraulike.
- b- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- c- Ujësjellës kanalizime urbane - rurale.
- d- Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga deri 10m - damba.
- e- Vepra të trajtimit të ujit.
- f- Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi – kulla ekuilibri– porte - pontile.
- g- Vepra naftësjellës – gazsjellës – vajsjellës etj.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

- a- Rugë auto kategoria V dhe IV.
- b- 1. Projektim rruge kategoria III dhe II – 2. Kategoria I.
- c- Shtresa rrugore e sistemim - asfaltim.
- d- Autostrada – aeroporte – helioporte.
- e- Hekurudha – degëzime hekurudhore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

- a- Ura dhe vepra arti të vogla deri me 10 m.
- b- Ura dhe vepra arti mbi 10 m - Estakada.
- c- Ura metalike.
- d- Tunele rrugore - hekurudhore.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a- Bazamente gjeodezike – rivelime në të gjitha shkallët.
- b- Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a- Studim/Vlerësim gjeologo inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- b- Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.
- c- Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
- d- Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- e- Studime e projekte hidrogjeologjike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

- a- Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare).
- b- Centrale termike (primare, sekondare).
- c- Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj.
- d- Nënstacione elektrike, primar sekondar – linja të tensionit të lartë.
- e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

- a- Në rrugë auto kategoria V, IV, III, II.
- b- Në rrugë auto kategoria I, autostrada dhe në degëzime me hekurudhën.
- c- Në aeroporte dhe heliporte.

TABELA E KLASIFIKIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT

- Sipas klasave dhe kategorive -

1. GËRMIME DHEU ME PUNIME EVENTUALE MURATURE E BETONARME – PRISHJE DHE PUNIME NË TOKË TË GËRMUAR.

2. PRODHIM MATERIAL NDËRTIMI

- a- 1. Prodhim materiale inerte – 2. gurë.
- b- 1. Prodhime qeramike tulla – tjegulla – 2. fajancë.
- c- 1. Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm – 2. paranderur – 3. gurë dekorativë – mermer.
- d- 1. Prodhim materiale lidhës gëlqere – 2. allçi – 3. çimento.
- e- 1. Prodhim materiale me bazë bitumi – 2. sintetike – 3. druri – 4. metali.

3. NDËRTIME CIVILE DHE EKONOMIKE

- a- Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore deri në 5 kate.
- b- 1. Ndërtime civile – industriale – turistike – bujqësore mbi 5 kate – 2. Rikonstruksione.
- c- Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.

4. NDËRTIME RRUGORE

- a- Ndërtim rruge kategoria IV dhe V.
- b- 1. Ndërtim rruge kategoria III dhe II – 2. Kategoria I.
- c- Punime të mirëmbajtjes në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore.
- d- Ndërtim autostrade – aeroporte - heliporte.

5. NDËRTIME HEKURUDHORE

- a- Punime hekurudhore.
- b- Punime speciale të shinave dhe traversave.
- c- Punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit.

6. NDËRTIM URA DHE VEPRA ARTI

- a- Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m.
- b- 1. Ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m – 2. Estakada – 3. Ura metalike.
- c- Ndërtim tunele rrugore - hekurudhore.

7. NDËRTIME DETARE

- a- Ndërtime portuale – bankina – basene - pontile.
- b- Punime thellimi – drenimi.

8. NDËRTIME HIDRAULIKE E HIDROTEKNIKE

- a- 1. Ndërtim ujësjellës – kanalizime – 2. kanale e impiante vaditjeje – kullimi.
- b- Punime mbrojtje të sistemit hidraulik – çimentime etj.
- c- Ndërtim impiante të trajtimit të ujit.
- d- Ndërtim vajsjellës – gazsjellës – naftësjellës.
- e- Ndërtim diga – damba deri 10 m.
- f- Ndërtim galeri - tunele.
- g- Ndërtim diga të larta.

9. VEPRA TË VEÇANTA E PUNIME SPECIALE

- a- 1. Sillose, kulla, kulla uji etj., b/a – 2. metalike.
- b- Përforcime themeli e punime nëntokësore.
- c- Izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat.
- d- Themele të veçanta.
- e- 1. Puse – shpime gjeologo-inxhinierike – 2. shpime për ujë.

10. PUNIME RESTAURIMI

- a- Restaurimi i ndërtesave monument kulture.
- b- Punime restaurimi në vepra arkeologjike.

11. PUNIME KARPENTERIE

- a- Druri.
- b- Metali.

12. IMPIANTE TEKNOLOGJIKE DHE TË VEÇANTA

- a- Instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues në përgjithësi) – mirëmbajtja e tyre.
- b- Instalimi i impianteve termike – ventilimit – kondicionimit të ajrit – mirëmbajtja e tyre.
- c- Instalimi i sistemit hidrosanitar në objekte civile, industriale, bujqësore etj. – mirëmbajtja e tyre.
- d- Instalimi i impianteve hidraulike e hidrosanitare e të sigurimit të kontrollit – mirëmbajtja e tyre.
- e- Montimi i materialeve metalike – plastike – xhami etj.
- f- 1. Punime bojatisje – hidroizolimi – termoizolimi – akustikë – 2. kundra zjarrit.
- g- Instalimet e impianteve nën presion – mirëmbajtja e tyre.

13. PUNIME NË IMPIANTET E PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

- a- Montim centrale hidraulike – prova me ngarkesë.
- b- Montim centrale termike – prova me ngarkesë.
- c- Impiante për prodhimin e energjisë nga burime alternative.
- d- Instalime për n/stacionet – kabinat e transformatorëve – linjat e T.N e të mesëm.
- e- Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike të T.U linjave për telefoni, radiotelefoni, televizive citofoni – mirëmbajtja e tyre.

14. PUNIME SHËRBIMI

- a- Ndriçimi dhe sinjalizimi urban.

15. PUNIME TOPOGJEODEZIKE

- a- Rivelime topografike.
- b- Punime topogjeodezike në objekte inxhinierike.
- c- Punime speciale gjeodezike, rrjeta mbështetëse, qëndrueshmëri terrenesh.
- d- Punime fotogrametrike - hartografike.

16. PUNIME TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a- Në rrugë auto kategoria V, IV, III, II.
- b- Në rrugë auto kategoria I, autostrada dhe në degëzime me hekurudhën.
- c- Në aeroporte dhe heliporte.

TABELA E KATEGORIVE TË MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

- Sipas klasave dhe kategorive-

A. PUNIME CIVILE DHE INDUSTRIALE

1. Ndërtime civile, industriale, turistike, sportive, bujqësore deri 5 kate.
2. Ndërtime civile, industriale, turistike, sportive, bujqësore mbi 5 kate – rikonstrukcione.
3. Ndërtime me shkallë të lartë të vështirësisë, me skelet betonarme dhe metalike – ndërtime mbi 8 kate - guacka, sillose, kulla etj.
4. Punime të trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

B. PUNIME RRUGORE DHE HEKURUDHORE

1. Rugë kategoria V dhe VI.
2. Rugë kategoria III, II dhe I, – shtresa rrugore, sistemim asfaltim.
3. Autostrada – heliporte – aeroporte.
4. Linja e degëzime hekurudhore.

C. VEPRA ARTI

1. Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 metra.
2. Ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 metra – estakada, ura të varura.
3. Tunele rrugore e hekurudhore.

D. PUNIME HIDRAULIKE DHE HIDROTEKNIKE

1. Ndërtim ujësjellës të jashtëm, kolektorë shkarkimi – impiante vaditëse.
2. Ndërtim ujësjellës-kanalizime, urbane rurale.
3. Ndërtim impiante të trajtimit të ujit
4. Vepra marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri etj.
5. Diga, galeri, tunele, damba.
6. Porte dhe pontile.

E. PUNIME INSTALIMI

1. Hidrosanitare.
2. Termoteknike, ventilim, kondicionim.
3. Linja elektrike të T/U radiotelefoni, citofoni, TV, sisteme alarmi.
4. Sistemet e furnizimit me gaz, naftë dhe vajsjellës.

F. PUNIME TEKNOLOGJIKE DHE TË MONTIMIT

1. Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj).
2. Centrale hidraulike.
3. Centrale termike.
4. Impiante të prodhimit të energjisë alternative.
5. N/stacionet elektrike primar, sekondar.
6. Linjat e T/N dhe të mesëm.

G. PUNIME SHËRBIMI

1. Punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe - pyllparqe.
2. Zhvillimi i dekorit në mjedise urbane.
3. Punime shërbimi - pastrimi.

H. PUSE-SHPIME GJEOLIGO INXHINIERIKE- SHPIME PËR UJË.

I. PUNIME TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

1. Në rrugë auto kategoria V, IV, III, II.
2. Në rrugë auto kategoria I, autostrada dhe degëzime me hekurudhën.
3. Në aeroporte dhe heliporte.

KUSHTE DHE KRITERE PËR TË FITUAR KLASA DHE KATEGORI TË PROJEKTIMIT NGA PERSONA FIZIKË DHE SHOQËRITË

1. PROJEKTUES URBANIST

1. Profili sipas kategorive të projektimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili urbanist.
- b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili arkitekturë.
- Urbanist.
- c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, para vitit 1971.
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili arkitekturë.
- Urbanist.

2. Vjetërsia në punë, në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose Universiteti Politeknik sipas kategorive:

- a- Mbi 10 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 5 vjet

2. PROJEKTUES ARKITEKT

1. Profili për kategorinë a ÷ d projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili Arkitekturë.
- Inxhinier ndërtimi profili ndërtues i përgjithshëm, strukturist vetëm për kategorinë a.

2. Profili për kategorinë e të projektimit:

- Të ketë mbaruar Institutin Bujqësor profili inxhinier gjelbërimi.
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili urbanist, arkitekt.

3. Vjetërsia në punë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose Universiteti Politeknik:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 10 vjet
- c- Mbi 7 vjet
- d- Mbi 7 vjet
- e- Mbi 5 vjet

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

1. Profili për kategorinë a të projektimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.

- Inxhinier hidroteknik.
- Inxhinier, ndërtime civile industriale.
- Inxhinier ndërtimi profili strukturist, ndërtues i përgjithshëm.

2. Profili për kategorinë b dhe c të projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier, ndërtime civile industriale.
- Inxhinier ndërtimi profili strukturist.

3. Vjetërsia në punë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose Universiteti Politeknik:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 10 vjet

4. PROJEKTUES INSTALATOR

1. Sipas kategorive të projektimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtime hidroteknike.

- b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier mekanik deri në vitin 1967.

- nxhinier mekanik.
- c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier elektrik deri në vitin 1967.
- Inxhinier elektrik, - rryma të ulëta - elektronik.
- d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier elektrik deri në vitin 1967.
- Inxhinier elektrik, - rryma të ulëta - elektronik.
- e- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier mekanik deri në vitin 1967.
- Inxhinier mekanik.

2. Vjetërsia në punë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose Universiteti Politeknik

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 7 vjet
- d- Mbi 10 vjet
- e- Mbi 7 vjet

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

1. Për kategoritë a : f të projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtime hidroteknike.

2. Për kategorinë g të projektimit

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier hidroteknik.
- Inxhinier mekanik.

3. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik:

- a- Mbi 15 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 5 vjet
- d- Mbi 7 vjet
- e- Mbi 10 vjet
- f- Mbi 15 vjet
- g- Mbi 10 vjet

6. PROJEKTUES RRUGË - HEKURUDHA

1. Për kategoritë a ÷ c të projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier për ndërtime civile.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, për infrastrukturë transporti.

2. Për kategorinë d dhe e të projektimit:

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, për infrastrukturë transporti.

3. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik:

- a- Mbi 3 vjet.
- b- Mbi 15 vjet.
- c- Mbi 7 vjet.
- d- Mbi 20 vjet
- e- Mbi 15 vjet.

7. PROJEKTUES URA DHE VEPRA ARTI

1. Për kategoritë a dhe b të projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtime civile, industriale, hidroteknike.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, për infrastrukturë transporti.

2. Për kategorinë c të projektimit:

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, hidroteknike.
- Inxhinier ndërtimi strukturist, për infrastrukturë transporti.

3. Për kategorinë d të projektimit:

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, hidroteknike.
- Inxhinier ndërtimi për infrastrukturë transporti.

4. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 10 vjet
- c- Mbi 10 vjet
- d- Mbi 15 vjet

8. PROJEKTUES GJEODET

1. Për të gjitha kategoritë:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier gjeodet.

2. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik.

- a- Mbi 7 vjet
- b- Mbi 15 vjet

9. STUDIUES - PROJEKTUES GJEOLIGO-INXHINIERIK

1. Për të gjitha kategoritë:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili gjeolog i përgjithshëm.
- Inxhinier hidrogeolog.

2. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 10 vjet
- d- Mbi 15 vjet
- e- Mbi 10 vjet

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

1. Për të gjitha kategoritë:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier elektrik.

2. Vjetërsia në punë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose Universitetin Politeknik:

- f- Mbi 15 vjet
- g- Mbi 15 vjet
- h- Mbi 15 vjet
- i- Mbi 10 vjet
- j- Mbi 5 vjet

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

1. Për kategoritë a-c të projektimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier trafiku rrugor, profile inxhinier mekanik, profili inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore dhe për infrastrukturën në transport.

2. Vjetërsia në punë në subjekte publike dhe jopublike projektuese, në Universitetin Politeknik dhe institucione që merren me zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit dhe inspektimet teknike rrugore:

- a- Mbi 3 vjet
- b- Mbi 7 vjet
- c- Mbi 7 vjet

Shënim.

Për diploma të fituara nga studentë shqiptarë jashtë vendit bëhet konvertimi i saj nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

LIDHJA 6

KUSHTE DHE KRITERE PËR TË FITUAR KLASA DHE KATEGORI TË ZBATIMIT NGA PERSONA

FIZIKË DHE SHOQËRITË

1. GËRMIME DHEU ME PUNIME EVENTUALE MURATURE E BETONARME, PRISHJE PUNIME NË DHE TË GËRMUAR.

1. Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi, deri në vitin 1971.
 - Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, rrugore etj.
 - Inxhinier gjeodet.
2. Vjetërsia në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, jo më pak se 2 vjet me rekomandime për punime konkrete.

2. PRODHIM MATERIAL NDËRTIMI

1. Për kategoritë e zbatimit:
 - a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile industriale, hidroteknike etj.
 - Inxhinier gjeolog.
 - b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, profili Kimi Industriale.
 - c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, rrugore etj.
 - d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, profili Kimi Industriale.
 - e- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili inxhinier për ndërtime civile industriale, rrugore etj.
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës profili Kimi Industriale.
2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 2 vjet
 - b- Mbi 5 vjet
 - c- Mbi 2 vjet
 - d- Mbi 5 vjet
 - e- Mbi 7 vjet për profilin e ndërtuesit, mbi 5 vjet për Kimi Industriale.

3. NDËRTIME CIVILE DHE EKONOMIKE

1. Për të gjitha kategoritë:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, rrugore dhe inxhinier ndërtimi i përgjithshëm, strukturist.
 - Arkitekt vetëm për kategorinë a të zbatimit.
2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 2 vjet
 - b- Mbi 10 vjet
 - c- Mbi 15 vjet

4. NDËRTIME RRUGORE

1. Për kategoritë a – c të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtime rrugore, inxhinier ndërtimi për infrastrukturën në transport.
 - Inxhinier gjeodet për kategorinë a të zbatimit.
2. Për kategorinë d të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit për ndërtime rrugore dhe profili inxhinier ndërtimi për infrastrukturën në transport.
3. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 2 vjet
 - b- Mbi 10 vjet

- c- Mbi 10 vjet
- d- Mbi 10 vjet

5. NDËRTIME HEKURUDHORE

1. Për kategorinë a dhe b të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtime rrugore dhe inxhinier ndërtimi për infrastrukturën në transport.
2. Për kategorinë c të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtime rrugore dhe inxhinier ndërtimi për infrastrukturën në transport.
 - Inxhinier elektrik - elektronik.
3. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 5 vjet
 - b- Mbi 10 vjet
 - c- Mbi 10 vjet

6. NDËRTIME URA DHE VEPRA ARTI

1. Për kategorinë a dhe b të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtime rrugore dhe inxhinier ndërtimi për infrastrukturën në transport.
 - Inxhinier gjeodet për kategorinë a të zbatimit.
2. Për kategorinë c të zbatimit:
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili inxhinier për ndërtime rrugore hidroteknike dhe për infrastrukturën në transport.
3. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 7 vjet
 - b- Mbi 15 vjet
 - c- Mbi 10 vjet

7. NDËRTIME DETARE

1. Sipas kategorive të zbatimit:
 - a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime hidroteknike, rrugore dhe Infrastrukturë në transport.
 - b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili inxhinier hidroteknik dhe për infrastrukturë në transport.
2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:
 - a- Mbi 10 vjet
 - b- Mbi 15 vjet

8. NDËRTIME HIDRAULIKE DHE HIDROTEKNIKE

1. Sipas kategorive të zbatimit:
 - a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale dhe inxhinier hidroteknik.
 - b- Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Inxhinier për ndërtime civile, industriale dhe inxhinier hidroteknik.
 - c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili hidroteknik, mjedis.
 - d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili hidroteknik.
 - Inxhinier mekanik.
 - e- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili Inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili hidroteknik.
 - f- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili hidroteknik.
- g- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi hidroteknik.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

- a- Mbi 3 vjet
- b- Mbi 15 vjet
- c- Mbi 10 vjet
- d- Mbi 10 vjet
- e- Mbi 7 vjet
- f- Mbi 15 vjet
- g- Mbi 15 vjet

9. VEPRATË VEÇANTA E PUNIME SPECIALE

1. Sipas kategorive të zbatimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale dhe hidroteknike.
- Inxhinier ndërtimi strukturist, ndërtues i përgjithshëm.
- Inxhinier mekanik vetëm kur janë metalike.
- b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, rrugore dhe inxhinier ndërtimi strukturist, ndërtues i përgjithshëm.
- c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike dhe ndërtues i përgjithshëm.
- d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike ndërtime rrugore dhe për infrastrukturën në transport, strukturist dhe ndërtues i përgjithshëm.
- e- Inxhinier gjeolog – hidrogjeolog.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 10 vjet
- c- Mbi 10 vjet
- d- Mbi 15 vjet
- e- Mbi 15 vjet

10. PUNIME RESTAURIMI

1. Sipas kategorive të zbatimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, arkitekturë, ndërtues i përgjithshëm, strukturist.
- b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier për ndërtime civile, industriale, arkitekturë, ndërtues i përgjithshëm, strukturist.
- Arkeolog.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, në ndërtim:

- a- Mbi 10 vjet
- b- Mbi 15 vjet

11. PUNIME KARPENTERIE

1. Sipas kategorive të zbatimit:

- a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.
- Inxhinier për ndërtime civile, industriale, arkitekturë, hidroteknike, ndërtime rrugore, ndërtues i përgjithshëm, strukturist, infrastrukturë transporti.
- b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, arkitekture, hidroteknik, ndërtime rrugore, ndërtues i përgjithshëm, strukturist, infrastrukturë transporti.

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

a- Mbi 7 vjet

b- Mbi 10 vjet

12. IMPIANTE TEKNOLOGJIKE DHE TË VEÇANTA

1. Sipas kategorive të zbatimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili mekanik.

b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili mekanik.

c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971.

- Inxhinier për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtues i përgjithshëm.

- Inxhinier mekanik.

d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin mekanik.

e- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier ndërtimi deri vitin 1971.

- Inxhinier për ndërtime civile industriale, ndërtues i përgjithshëm.

- Inxhinier mekanik.

f- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier ndërtimi nga viti 1971.

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile, industriale, hidroteknike, ndërtues i përgjithshëm.

- Inxhinier mekanik.

g- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili mekanik.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

a- Mbi 5 vjet

b- Mbi 10 vjet

c- Mbi 3 vjet

d- Mbi 15 vjet

e- Mbi 3 vjet

f- Mbi 5 vjet

g- Mbi 10 vjet

13. PUNIMET NË IMPIANTET E PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË.

1. Sipas kategorive të zbatimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili elektrike.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili elektrike.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.

c- Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, profili elektrike.

d- Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, profili elektrike.

e- Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, profili elektrike nga viti 1957 e në vazhdim dhe në profilin elektronik nga viti 1980 e në vazhdim.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

a- Mbi 10 vjet

b- Mbi 15 vjet

c- Mbi 10 vjet

d- Mbi 15 vjet

e- Mbi 5 vjet

14. PUNIME SHËRBIMI

1. Sipas kategorive të zbatimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në profilin arkitekturë, urbanist, mjedis, Institutin Bujqësor në degën pyjore - agronomi.

b- Të ketë mbaruar arsimin e lartë ose të mesëm.

c- Të ketë mbaruar arsimin e lartë ose të mesëm.

d- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në profilin arkitekturë, urbanist.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në degën elektrike dhe elektronike për kategorinë 14d – 2.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

- a- Mbi 3 vjet
- b- Mbi 3 vjet për arsimin e lartë dhe mbi 7 vjet për arsimin e mesëm
- c- Mbi 3 vjet për arsimin e lartë dhe mbi 5 vjet për arsimin e mesëm
- d- Mbi 5 vjet

15. PUNIMET TOPOGJEODEZIKE.

1. Sipas kategorive të zbatimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier ndërtimi.

- Gjeodezi nga viti 1960.

b- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier ndërtimi.

- Gjeodezi nga viti 1960.

c- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, në profilin inxhinier gjeodet nga viti 1960.

d- Të ketë mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, në profilin inxhinier gjeodet nga viti 1960.

2. Vjetërsia e nevojshme në punë, në sektorin publik ose në shoqëri të ndryshme private, sipas kategorive përkatëse:

- a- Mbi 5 vjet
- b- Mbi 10 vjet
- c- Mbi 15 vjet
- d- Mbi 15 vjet

16. PUNIME TË SINJALIZIMIT RRUGOR

1. Për kategoritë a-c të zbatimit:

a- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili Inxhinier trafiku rrugor, profili inxhinier mekanik, profili inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore dhe për infrastrukturën në transport.

2. Vjetërsia në punë në subjekte publike dhe jopublike zbatuese, në Universitetin Politeknik dhe institucione që merren me zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit dhe inspektimet teknike rrugore:

- a- Mbi 3 vjet
- b- Mbi 5 vjet
- c- Mbi 5 vjet

Shënim.

Për diplomë të fituar nga studentë shqiptarë jashtë vendit bëhet konvertimi i saj nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

LABORATORËT E KONTROLLIT TË MATERIALEVE TË NDËRTIMIT DHE KLASIFIKIMI I TYRE

- Laboratorët e kontrollit të materialeve të ndërtimit ushtrojnë aktivitet mbi bazën e licencës profesionale, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit.

- Për marrjen e licencës së laboratorit është e domosdoshme të kryhet një vizitë teknike në laboratorin, që kërkon të licencohet, nga grupi i ekspertëve.

- Grupi i ekspertëve miratohet nga kryetari i Komisionit.

Grupi përbëhet nga tre persona, njëri prej të cilëve është i përhershëm dhe specialist i ministrisë.

Anëtarët e tjerë të grupit të ekspertëve përcaktohen në përputhje me fushat në të cilat kërkohet të licencohet laboratorin.

- Grupi i ekspertëve brenda një jave nga data e marrjes së detyrës kryen vizitën teknike dhe përpilon raportin teknik, një kopje e të cilit i jepet kërkuesit të licencës dhe një kopje i dërgohet sektorit të licencave.

- Raporti duhet të përmbajë: Përshkrimin e manualit të laboratorit, në të cilin janë të dhënë në mënyrë të përgjithshme, lloji i provave dhe analizave të kërkuara, mënyra e kryerjes së tyre, marrjen e mostrës dhe të dhënat e saj, modelin e certifikatës së cilësisë dhe të dokumentacionit tjetër teknik.

- Laboratorët klasifikohen si më poshtë:

Laboratori i materialeve të ndërtimit

L1 – M.N

Laboratori i provave të strukturave të ndërtimit.

L2 – S.N

Laboratori i provave gjeoteknike dhe të gjeologjisë.

L3 – GJT.GJ

Kushtet dhe kriteret për laboratorët dhe drejtuesit teknikë të tyre propozohen nga ekspertët dhe miratohen nga Komisioni.

Një pjesë e provave sipas klasifikimit të laboratorëve jepen më poshtë:

A. LABORATORË TË PROVAVE TË MATERIALEVE TË NDËRTIMIT

a - Analiza të përbërësve të betonit

1. Përbërja e kokrrizave të betonit.

2. Përcaktimi i masës vëllimeve të dukshme (zhavore, çakëll, rërë).

3. Përcaktimi i rezistencës në shtypje, i përbërësve dhe i gurit meme.

4. Përcaktimi i përmbajtjes së substancave organike e papastërtive.

5. Përcaktimi i koeficientit të thyerjes dhe copëzimit.

6. “ “ të bufatjes dhe lëmueshmërisë.

7. “ “ të porozitetit dhe absorbimit të ujit të inerteve.

8. Përcaktimi i përmbajtjes së sulfatave e klorureve.

9. Prova të tjera.

b. Provat e çimentos

1. Përcaktimi i vetive mekanike (rezistencë në shtypje, tërheqje, përkulje).

2. Përcaktimi i vetive fizike (fillim e mbarim preze, stabiliteti, fundi i prezës, imtësia, sipërfaqja specifike).

3. Përcaktimi i konsistencës së llaçit të çimentos (në tavolinë vibruese).

4. Përcaktimi i cilësive kimike (humbje nga zjarri, mbetje e patretur, përmbajtje e sulfatave, klorureve, bioksidgeve të silicit, hekurit, titanit, CaO).

5. Përcaktimi i masës vëllimore të llaçit të freskët.

6. Përcaktimi i shtresave inerte dhe aktive (përbërje kimike, përcaktimi i pucolanitetit).

7. Analiza kimike për ujin që përdoret në përgatitjen e llaçeve.

8. Prova të tjera.

c. Provat e çelikeve

1. Përcaktimi rezistencës në tërheqje e këputje.

2. Prova në lakim e shufrave të çelikut.

3. Përcaktimi i zgjerimit dhe ngushtimit relativ.

4. Përcaktimi i treguesit të aderencës.

5. Prova në tërheqje e shkëputje e rrjetave të salduara.

6. Prova në tërheqje e tufës ose gërshetit me shumë fije.
7. Kontrolli i shkallës së konsolidimit të çelikut.
8. Prova të tjera.

ç. Prova të betonit e llaçeve

1. Prova në shtypje.
2. Përcaktimi i modulit të elasticitetit.
3. Kontrolli i përbërjes së betonit të freskët dhe projektimi i recetës së betoneve.
4. Përcaktimi i konsistencës.
5. “ “ i masës vëllimore të betonit.
6. “ “ i absorbimit të ujit.
7. “ “ i penetrimit të jonit sulfat e klor.
8. Përcaktimi për papërshkueshmërinë ndaj ujit.
9. Kontrolli i rezistencës ndaj ngricës.
10. Kontrolli me sklerometër.
11. Prova të tjera.

d. Prova të gurëve natyralë

1. Masa vëllimore e dukshme.
2. Absorbimi i ujit.
3. Provat në shtypje.
4. Provat në ngrirje.
5. Provat në tërheqje indirekte.
6. Provat në përkulje.
7. Përcaktimi i shkallës së agresivitetit të atmosferës.
8. Prova të tjera.

e. Prova të tullave e pllakave

1. Rezistenca në shtypje.
2. Rezistenca në përkulje.
3. Përcaktimi i pamjes së jashtme, përqindjes së vrimave, përmasave.
4. Përcaktimi i masës vëllimore.
5. Përcaktimi i rezistencës në tërheqje e në prerje.
6. Përcaktimi i absorbimit të ujit dhe rrezikut të ngricës.
7. Përcaktimi i modulit të elasticitetit.
8. Përcaktimi përmbajtjes së gëlqeres.
9. Prova të tjera.

f. Prova të bitumeve e përzierjeve bituminoze

1. Prova e penetrimit.
2. Pika e zbutjes.
3. Pika e shkatërrimit.
4. Përcaktimi i dendësisë dhe peshës vëllimore.
5. Përcaktimi i pikës së flakërimit.
6. Përcaktimi i duktilitetit.
7. Përcaktimi i humbjes në peshë.
8. Përcaktimi i peshës vëllimore dhe koeficientit të mufatjes.
9. Përcaktimi i përshkueshmërisë nga uji dhe i ujëthithjes.
10. Prova e thyerjes, nxjerrja e koeficientit të thyerjes.
11. Projektimit i recetës së asfaltobetonit.
12. Shmangiet në traun Benkelman.
13. Përkimi me tokën.
14. Mikro dhe makroashpërsia.
15. Përcaktimi i dendësisë së shtresave të asfaltit.
16. Përcaktimi i përqindjes së porozitetit.
17. Përcaktimi i spesorit të shtresave.
18. Prova të tjera.

- g. Prova të punimeve të bojrave
1. Përcaktimi i konsumit të bojës.
 2. Përcaktimi i spesorit të bojës mbi strukturën metalike në vend.
 3. Përcaktimi i rezistencës ndaj temperaturës.
 4. Prova të tjera.

- h. Prova me drurin
1. Provat në tërheqje.
 2. Masa vëllimore.
 3. Provat në kompresion.
 4. Rezistenca në shtypje.
 5. Prova të tjera.

- i. Prova me tubat PVC
1. Masa vëllimore.
 2. Prova në tërheqje.
 3. Prova në shtypje.
 4. Prova në përkulje.
 5. Prova të tjera.

- j. Prova hidraulike
1. Provat hidraulike në elemente të ndryshme si ventila, saraçineska etj.
 2. Prova hidraulike në tubacione (çeliku, betoni, PVC, fibroçimentoje).
 3. Prova të tjera.

B. LABORORË TË PROVAVE TË STRUKTURAVE TË NDËRTIMIT

1. Matja e deformimeve në elemente të ndryshme në shkallë reale.
2. Përcaktimi i forcës shkatërruese.
3. Kontrolli i aftësisë mbajtëse të elementeve të veçanta.
4. Prova në ngarkim statik të strukturës.
5. Prova të tjera.

C. LABORATOR GJEOTEKNIK

- a. Provat në shkëmbinj
1. Rezistenca në shtypje.
 2. Rezistenca në tërheqje (provë indirekte).
 3. Rezistenca në prerje.
 4. Përcaktimi i modulit të deformimit e të gjendjes së sforcuar.
 5. Përcaktimi i vetive fizike (lagështia, pesha vëllimore, pesha specifike, poroziteti, përbërja kokrrizore).
 6. Përcaktimi i filtrimit të shkëmbit.
 7. Prova të tjera.

- b. Prova në dherat që shërbejnë si bazament
1. Përbërja e kokrrizave me sita pipette ose aerometër.
 2. Përcaktimi i peshës specifike, peshës vëllimore e lagështisë.
 3. Përcaktimi i kufijve të plasticitetit.
 4. Provat adometrike dhe përcaktimi i modulit të deformimit të përgjithshëm.
 5. Provat e rezistencës në prerje (prerje direkte, provat në triaksial).
 6. Provat e treguesit të aftësisë mbajtëse SBR.
 7. Përcaktimi i porozitetit maksimal e minimal të rrëave.
 8. Provat në piastër për ngarkimin static.
 9. Moduli i reaksionit.
 10. Përcaktimi i koeficientit të filtrimit.
 11. Prova të tjera.

- c. Provat e dherave që shërbejnë si lëndë e parë për veprat inxhinierike
1. Përcaktimi i granulometrisë me metodën me sita dhe hidrometrike (pipetë ose aerometër).

2. Përcaktimi i plasticitetit (kufiri i sipërm, i poshtëm, treguesi).
3. Përcaktimi i vetive fizike (pesha vëllimore, specifike, lagështia natyrore).
4. Provat e ngjeshjes dinamike (standard dhe i modifikuar).
5. Provat e ngjeshjes në tavolinë vibruese për lëndët e shkrifta.
6. Provat e kontrollit për ngjeshjet në vend me metodën e konit me rërë.
7. Provat CBR (aftësia mbajtëse kaliforniane) për mbushjet.
8. Provat adometrike.
9. Provat e rezistencës në prerje (direkte dhe triaksiale).
10. Provat e filtrimit.
11. Provat Los Anxhelos për lëndët e shkrifta kokrrizore.
12. Ekuivalenti i rërës.
13. Lënda organike.
14. Petrografia dhe forma e kokrizave, alternimi me sulfat Na ose Mg.
15. Prova të tjera.

d. Provat fushore

1. Provat në penetrim.
2. Provat në pjastër (ose pllakë).
3. Provat CBR.
4. Pesha vëllimore.
5. Prova me ngjeshje me kon me rërë.
6. Kufijtë e plasticitetit.
7. Përbërja kokrrizore.
8. Provat me presiometër.
9. Provat SPT.
10. Prova të tjera.

VETËDEKLARIMET

8/1. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

8/2. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

Gjithashtu deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri për zbatim punësh publike”.

8/3. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

- Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë : Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

- Nuk jam i punësuar në rolin e drejtuesit teknik në anjë shoqëri tjetër përjashtuar këtë ku aplikoj dhe nuk jam në marrëdhënie pune me institucione qendrore e buxhetore apo në organe, aktiviteti i të cilave bie ndesh me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.657 datë 16.9.1996 “Për rregullat e etikës në shërbimin civil” ndryshimet e mëvonshme dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre”.

8/4. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem dhe nuk kam asnjë penalizim të licencës aktuale nga organet e policisë së ndërtimit (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale _____ nga dega e Policisë së Ndërtimit _____ (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)”.

8/5. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem dhe nuk kam asnjë penalizim të licencës aktuale nga organet e Policisë së Ndërtimit (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale _____ nga dega e Policisë së Ndërtimit _____ (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)”.

Gjithashtu deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri për zbatim punësh publike”.

8/6. “Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë dhe nuk kam asnjë penalizim të licencës aktuale të shoqërisë që drejtoj nga organet e policisë së ndërtimit (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale _____ nga Dega e Policisë së Ndërtimit _____ (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)”.

SHOQËRIA -----Nr. Licencës -----

VENDNDODHJA ----- PERIUDHA VEPRIMTARISË -----
TË DHËNA PËR PUNIME E MATERIALE NDËRTIMI

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
A	Stafi dhe punonjësit		
1.	Gjithsej	numër	
2.	Inxhinier ndërtimi	“	
3.	Inxhinier elektrik	“	
4.	Inxh.Instal.mekanik	“	
5	Ekonomist	“	
6.	Jurist	“	
7.	Teknik i mesëm	“	
B	Punëtorë të siguruar mesatarisht	“	
C	Paga mesatare mujore punonjës	Lekë	
D	Makineri e mjete transporti	Lekë	
1.	Vinç mbi 1 ton	Copë	
2.	Autovinç mbi 5 T	“	
3.	Mjete ngarkimi	“	
4.	Autobetoniera	“	
5.	Beton pompa	“	
6.	Rul kompresor	“	
7.	Mjete transp – 8 T	“	
8.	Mjete tran. Mbi 8 T	“	
9.	Makinë shtuese	“	

DREJTUESI TEKNIK

DREJTUESI LIGJOR

1. Formulari të plotësohet dhe të dorëzohet në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit brenda datës 20 janar pranë Drejtorisë së Licencimit (Sektori i licencimit në ndërtim).
2. Mosdërgimi në afat me saktësi, kufizon të drejtat e shoqërisë për licencim.

SHOQËRIA -----Nr. Licencës -----

VENDNDODHJA ----- PERIUDHA VEPRIMTARISË -----
TË DHËNA MBI VEPRIMTARINË PROJEKTUESE DHE ZBATUESE

- a) Me fonde buxhetore
b) Me ndihma e kredi
c) Me fonde private dhe të vetë shoqërisë

Nr.	Emërtimi i objektit dhe vendi i ndërtimit	Vleftha 000/L e realizuar	Njësi	Tregues	
				gjithsej	Të veprës realizuar
I	Ndërtesa banimi, shkolla etj. a. b. c.		m ³		
II	Ndërtesa industriale a. b. c.		m ³		
III	Punime rrugore Rrugë, asfaltime ura etj. a. b.		m ² / m ³		
IV	Ujësjiellës-kanalizime		km		
V.	Ndërtime hidroteknike punime H/C, kullime, ujitje a. b.		m ³ / m/l		
VI	Punime të veçanta a. b.		m ³ m/l ton		
VII	Impiante teknologjike dhe të montimit a. b. c.		m/l m ³ ton		
	shuma I – VII a				
	shuma I – VII b				
	shuma I – VII c				
	Gjithsej Shoqëria				

DREJTUESI TEKNIK

DREJTUESI LIGJOR

Ky formular plotësohet për periudhën nga fillimi i aktivitetit të shoqërisë e deri më sot e pas kësaj çdo 6 muaj.

Formulari të shoqërohet me aktet e kolaudimit e marrjes në dorëzim të veprës dhe për projektuesit me kontratën e entit porositës.

Formulari të dorëzohet brenda datës 20 janar – 20 korrik në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, pranë Drejtorisë së Licencimit (Sektori i licencimit në ndërtim)

Mosdërgimi me afat e me saktësi, kufizon të drejtat e shoqërisë për licencim.

SHOQËRIA -----Nr. Licencës -----
VENDNDODHJA ----- Periudha veprimtarisë -----

TË DHËNA PËR PUNIME E MATERIALE NDËRTIMI

Nr.	Emërtimi	Nj ësia	S asia	Çmimi
A	Shoqëri ndërtimi			
1	Punime dheu – me krahë	m ³		
2	– Me makineri	m ³		
3	Themele - me gurë e butobeton	m ³		
4	Beton/arme	m ³		
5	Mur guri	m ³		
6	Mur - me tulla - të plotë	m ³		
7	- me bira	m ³		
8	Kollona e trarë b/arme	m ³		
9	Soleta monolite b/arme	m ³		
10	Soleta me panele e traveta	m ²		
11	Ndërtim çatie	m ²		
12	Hidroizolim solete	m ²		
13	Shtresë betoni M 100 – 200	m ³		
14	Shtresë me pllaka – qeramike	m ²		
15	- granili	m ²		
16	- mermeri	m ²		
17	Trotuare	ml		
18	Suvatim – i brendshëm	m ²		
19	- i jashtëm	m ²		
20	Patinim	m ²		
21	Dyer dritare vetrata druri	m ²		
22	Dyer vetrata d/a ose metalike	m ²		
B	Shoqëri prodhimi			
1	Tulla	000/c		
2	Çimento	ton		
3	Material inerte	m ³		
4	Parafabrikate e b/a	m ³		
5	Pllaka, qeramik, mermer, granil	m ²		
6	Betone	m ³		
7	Gëlqere	m ³		

DREJTUESI LIGJOR

DREJTUESI TEKNIK

Formulari të plotësohet dhe të dorëzohet në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit brenda datës 20 janar, pranë Drejtorisë së Licencimit (Sektori i licencimit në ndërtim) . Mosdërgimi me afat e saktësi kufizon të drejtat e Shoqërisë për licencim.

VENDIM
Nr.51, datë 15.9.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa a, dhe 16 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.9.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Energo Sas” sh.p.k. për licencimin për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për licencimin e shoqërisë “Energo Sas” sh.p.k., për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Sasaj.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Energo Sas” sh.p.k. dhe të njoftojë shoqërinë për mospranimin e kërkesës për përsheptimin e procedurave të licencimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.52, datë 15.9.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHOQËRINË “AMAL” SHPK PËR VITIN 2005 DHE VITIN
2006

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 “Të dhënat bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.9.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitet 2005 dhe 2006 dhe konstatoi se plotëson kërkesat formale të paraqitjes së një aplikimi,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitet 2005 dhe 2006.
 2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.53, datë 15.9.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHOQËRINË “MAKSI ELEKTRIK” SHPK
PËR VITIN 2006

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 “Të dhënat bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.9.2006, pasi shqyrtoj aplikimin e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006 dhe konstatoi se plotëson kërkesat formale të paraqitjes së një aplikimi,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2006.
 2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.55, datë 20.9.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “WTS
ENERGJI” SHPK PËR PERIUDHËN 1 TETOR 2005 DERI MË 31 DHJETOR 2005 DHE PËR
VITIN 2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b; 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 20.9.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “WTS Energji” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 tetor 2005 deri më 31 dhjetor 2005 dhe për vitin 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “WTS Energji” sh.p.k., për periudhën 1.10.2005 deri më 31.12. 2005, të jetë 4.6 lekë/kWh.
 2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “WTS Energji” sh.p.k. për periudhën 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2006, të jetë 4.6 lekë/kWh.
 3. Ngarkohen “WTS Energji” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.56, datë 20.9.2006

**PËR AFATIN E PARAQITJES SË APLIKIMEVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALET E VOGLA**

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 20.9.2006,

VENDOSI:

1. Të gjithë të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vogla, duhet të paraqesin aplikimin për rishikimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike, brenda datës 30 shtator të vitit paraardhës të periudhës për të cilën kryhet aplikimi.

2. Në rast të mosrespektimit të pikës 1 të këtij vendimi, ERE-s i lind e drejta të bëjë rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike.

3. Aplikimi duhet të paraqitet për një vit kalendarik.

4. Në kuptim të këtij vendimi, do të përfshihen në kategorinë e centraleve të vogla, centralet me një kapacitet deri në 5 MW, si dhe hidrocentrali i Smokthinës.

5. Shfuqizimin e vendimit nr.53, datë 26.9.2005.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

UDHËZIM
Nr.2, datë 20.9.2006

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29, pika 1, dhe 17 të ligjit nr.9087, datë 19. 6. 2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit të tij nr.54, datë 28.8.2006 “Për miratimin në parim të projektit për ringritjen e zyrave rajonale zgjedhore të KQZ-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të zyrave rajonale zgjedhore, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe caktimin e rregullave mbi marrëdhëniet me KQZ-në dhe me të tretët.

Neni 2

Parime të përgjithshme

I. Zyrat rajonale zgjedhore ringrihen për të vendosur një koordinim dhe komunikim më të mirë dhe më efikas midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, subjekteve zgjedhore dhe organeve të qeverisjes vendore, në funksion të miradministrit të procesit zgjedhor, rritjes së transparencës në veprimtarinë e KQZ-së.

II.ZRZ-të kanë funksion mbështetës në punën e KQZ-së. Ato nuk kanë kompetenca vendimmarrëse.

Neni 3

Gjatë veprimtarisë së tyre, ZRZ-të udhëhiqen nga parimet bazë të administrimit të një procesi zgjedhor, si:

a) ligjshmëria,

- b) transparenca,
- c) paanshmëria,
- d) profesionalizmi.

PJESA II VENDNDODHJA DHE PERSONELI I ZYRAVE RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 4 **Vendndodhja**

Zyrat rajonale zgjedhore ngrihen në qendrat e qarqeve.

Neni 5 **Përbërja e personelit**

ZRRZ-të përbëhen nga inspektori rajonal dhe inspektorët e rretheve që përbëjnë qarkun përkatës.

Neni 6 **Inspektori rajonal**

Në përzgjedhjen e inspektorit rajonal mbahen parasysh këto kriteret:

- a) Të ketë arsimin e lartë, me përparësi atë juridik;
- b) Të ketë jo më pak se dy vjet eksperiencë pune në administratë dhe/ose në fushën e zgjedhjeve;
- c) Të njohë programet bazë të kompjuterit;
- d) Të mos ketë lidhje gjinie dhe/ose krushqie deri në shkallën e dytë me ndonjë prej kandidatëve për kryetar bashkie a komune të njësive zgjedhore që përfshihen në qarkun përkatës;
- e) Të mos ketë qenë anëtar i forumeve drejtuese të ndonjë partie politike në tre vitet e fundit;
- f) Të mos jetë i zgjedhur dhe as kandidat në organet e qeverisjes vendore;
- g) Të mos jetë ushtarak, punonjës i policisë së shtetit dhe i Shërbimit Informativ Shtetëror;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të mos jetë në ndjekje penale për çështje zgjedhore;
- i) Të jetë me banim në qytetin qendër qarku.

Neni 7 **Inspektori i rrethit**

Inspektori i rrethit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi për inspektorin rajonal dhe duhet të jetë me banim në rrethin përkatës. Ai është ndihmësi i inspektorit rajonal në menaxhimin e problematikës së përditshme për rrethin që mbulon.

Neni 8 **Dokumenti i identifikimit**

Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori rajonal dhe inspektori i rrethit janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit që përdoret nga administrata e KQZ-së.

PJESA III EMËRIMI, SHKARKIMI DHE LIRIMI I PERSONELIT TË ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 9 **Emërimi i personelit të zyrës rajonale zgjedhore**

Personeli i zyrës rajonale zgjedhore emërohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 10

Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i personelit të zyrës rajonale zgjedhore

I. Shkarkimi nga detyra i personelit të ZRZ-së bëhet nga KQZ-ja me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, kur:

- a) nuk zbaton detyrat e ngarkuara;
- b) shkel parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi.

II. Lirimi nga detyra i personelit të ZRZ-së bëhet nga KQZ-ja me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) nuk plotëson kërkesat e nenit 6 të këtij udhëzimi.

PJESA IV

DETYRAT DHE TË DREJTAT E PERSONELIT TË ZYRËS RAJONALE ZGJEDHORE

Neni 11

Detyrat e personelit të zyrës rajonale zgjedhore

I. Personeli i zyrës rajonale zgjedhore ka për epror të drejtpërdrejtë Drejtorin e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore dhe kryen detyra të karakterit ekzekutiv dhe organizativ, si më poshtë:

- a) Realizon përcjelljen në kohë të vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së në KZQV, si dhe përcjelljen e vendimeve të KZQV-ve në KQZ;
- b) Jep ndihmesë në organizimin e trajnimeve të komisionerëve zgjedhorë;
- c) Mban kontakte të vazhdueshme me organet e qeverisjes vendore për probleme logjistike të shpërndarjes dhe grumbullimit të materialeve zgjedhore brenda afateve të përcaktuara në ligj;
- d) Mban kontakte me subjektet zgjedhore vendore;
- e) Informon KQZ-në në mënyrë të vazhdueshme mbi aktivitetin e komisioneve zgjedhore vendore;
- f) Kryen detyra të tjera sipas udhëzimeve të marra nga KQZ-ja.

Neni 12

Të drejtat e personelit të zyrës rajonale zgjedhore

Personeli i ZRZ-së gëzon mbështetjen e KQZ-së në kryerjen e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim. Atij i garantohen kushte të përshtatshme për zhvillimin normal të aktivitetit.

Neni 13

Komunikimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

I. ZRZ-të janë të detyruara të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore për çdo informacion apo raport të çdo natyre. DKZ-ja njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II. ZRZ-të kanë detyrimin t'u përgjigjen kërkesave për informacion të çdo anëtarit të KQZ-së dhe të komunikojmë drejtpërdrejt me ta.

PJESA V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Koha e punës

Personeli i zyrës rajonale zgjedhore zhvillon aktivitetin e vet sipas orarit të punës që aplikohet nga administrata e KQZ-së.

Neni 15

Paga

Personeli i zyrës rajonale zgjedhore gëzon pagën e inspektorit të përkohshëm të KQZ-së.

Neni 16

Baza materiale dhe dokumentacioni

Baza materiale e marrë në dorëzim dhe dokumentacioni i përdorur nga personeli i zyrës rajonale zgjedhore, në përfundim të periudhës së funksionimit të saj, dorëzohet në KQZ.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Çlirim Gjata

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000- 2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 2.10.2006
Doli nga shtypi më 4.10.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë